



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit e mbajtur me datë **19.10.2018** me fillim në ora **10.15**, këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete mbledhjes z. Bajram Morina.

Kryesuesi – Përshëndetje për Nënkryetarin e Komunës z. Fatmir Iska, përfaqësuesit e OSBE-së, UNMIK-ut, SHHL- Kosova, anëtarët e Komitetit për Komunitet dhe të gjithë të pranishmit. Konstatoj se kemi kuorum për mbajtjen e mbledhjes.

REND DITE

1. **Aprovimi i procesverbali nga mbledhjes së kaluar,**
2. **Shqyrtimi i paqartësive të rasteve sociale dhe problemi i papunësisë së komuniteteve,**
3. **Ofrimi emergjent i ndihmës momentale familjeve në nevojë gjatë sezonit dimërore,**
4. **Ndarja e mjeteve buxhetore nga buxheti i ZKK-së për ndërtimin e një biblioteke të leximit në fshatin Ratkoc,(Pika shtesë),**
5. **Të ndryshme.**

Kryesuesi – Para se ta qes rendin ditës në votim, kam një propozim edhe për një pikë shtesë nëse jeni të pajtimit edhe ju, emërtimi i pikës është: Ndarja e mjeteve buxhetore nga buxheti i ZKK-së për ndërtimin e një biblioteke të leximit në shkollën fillore “4 Dëshmorët” në fshatin Ratkoc. Në këtë shkollë edhe unë punoj, dhe kushtet janë shumë të dobëta për lexim. E qes në votim pikën shtesë: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika shtesë. Tani të nderuar anëtar të K. Komunitete e qes në aprovim rendin e ditës së bashku me pikën shtesë: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës.

1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhjes së kaluar.

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket pikë së parë, nëse jo e qes në aprovim Procesverbalin nga mbledhja e kaluar: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i paqartësive të rasteve sociale dhe problemi i papunësisë së komuniteteve.

Ne ftesën ja kemi dërguar një përfaqësuesi të QPS-së, besoj se shumë shpejtë do vije në mbledhje për të na dhënë një raporte rreth kësaj pike.

Afërdita Thaqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari kryesues pse nuk keni mare me kohë raportin nga QPS-ja dhe të na dërgoni neve para mbajtjes së mbledhjes, nuk ka logjik që të mbahet një mbledhje pa kurrfarë materiali vetëm me pikat e rendit të ditës. Po ashtu herrave tjera nëse dëshiron që të shtosh edhe ndonjë, pikë të rendit të ditës të na dërgosh materialin me kohë, nëse jo atëherë unë gjithmonë do jem kundër.

Kryesuesi – E nderuar unë vetë personalisht ja kam dërguar ftesën drejtorit të QPS-së, por ai nuk ka qenë në punë atë ditë, dhe nuk kam mundur që të mare kurrfarë raporti. Por besoj se herrave tjerë do ta keni materialin.

Bylbyl Oruçi - Drejtor i QPS-së, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kërkoj falje për vonesën, ne si QPS kemi diku rreth 640 familje shfrytëzuese të ndihmës sociale dhe nga ky numër një pjesë janë edhe nga komuniteti RAE, por ligji nuk e lejon ndarjen e komunitetit RAE nga komunitetet e tjera, pra nuk mundemi të dimë numrin e saktë se sa janë shfrytëzues të ndihmës sociale komuniteti RAE, sepse për ne sipas ligjit të gjithë janë të barabartë. Në kohën e fundit kemi probleme në raport me zyrën punësimi, bashkëpunimi në mes kësaj zyre dhe neve nuk është në nivelin e kënaqshëm, ne kemi qenë për vizitë tek zyra për punësim, dhe ne si QPS kemi paqartësi rreth punës së tyre, për arsye se një kategori e ndihmave sociale bazohet në certifikatën e papunësisë dhe pa këtë certifikatë ne nuk mundemi ta regjistrojmë një rast social, dhe shumica e sidomos

komuniteti RAE e ka problem me e mare këtë certifikatë. Arsyetimi i zyrës për punësim është se ka ndërmarrje private të cilët kërkojnë punëtor, kurse punëtorët me raste sociale nuk janë të interesuar që të shkojnë për të punuar, por ne si QPS kemi konstatuar se nuk është bash ashtu siç e thonë ata sepse kërkesat e ndërmarrjeve private janë ndoshta të vjetra 2-3 vite. Përndryshe rreth kësaj teme e kemi mbajtur edhe me OSBE-në një takim sqarues ku kanë qenë prezent edhe komunitetet, ku janë njoftuar me këtë problem, po ashtu i kam njoftuar me shkrimë edhe organet kompetente rreth këtij problemi, por problemi tjetër është se kjo zyre është në kuadër të agjensionit të punësimit në nivel qendrorë, ata për punën e tyre nuk i përgjigjen komunës. Kriteri për të marr ndihmë sociale është familja e jo vetëm një person dhe nëse një anëtar i familjes punësohet atëherë automatikisht përmes të dhënave të ATK-së, asaj familje i ndërpritet ndihma sociale.

Kryesuesi – I nderuari drejtor sipas ligjit janë disa kriter për të fituar ndihmën sociale, familja duhet të ketë fëmijën nën moshën 5 vjeçare, por do të doja nga ju një përgjigje i nderuari drejtor, a keni raste që një familje me të vërtet ka nevojë për ndihmë sociale por nuk e gëzon sepse nuk e ka fëmijën nën moshën 5 vjeçare.

Bylbyl Oruçi – Nëse një familje i plotëson kriteret atëherë ajo nuk ka kurrfarë probleme që të jetë përfituese e ndihmës sociale, por ka edhe raste ku kemi konstatuar që një familje është për ndihmë sociale sepse nuk ka kurrfarë të ardhura, por ata nuk i plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar ndihmë sociale. Kurse sa i përket fëmijëve, ndihma sociale ndahet në dy kategori, kategoria e parë e thamë që të ketë fëmijë nën moshën 5 vjeçare, kurse kategoria e dytë është që kushti kryesor të jetë gjendja e rëndë sociale, të jetë i papunë. Qendra për punë sociale përbëhet nga dy sektorë, është sektori i ndihmave sociale dhe sektori i shërbimit profesional.

Kryesuesi – I nderuari drejtor kam një kërkesë për ju, nëse ka mundësi që të rishikoni disa raste, sepse janë disa raste nuk kanë shtëpi janë duke jetuar me qira, nuk janë në gjendje që të sigurojnë as gjërat më elementare për ekzistencë.

Bylbyl Oruçi – Këtë që jeni duke kërkuar ju është problemi i vendbanimit ose strehimit të familjeve që nuk kanë shtëpi, për këtë Qendra për Punë sociale e komunës së Rahovecit nuk ka kurrfarë mundësia që të ja sigurojë. Ne kemi të dhënë për këto familje janë diku rreth 21 familje që janë në gjendje ekstreme të strehimit, ne si qendër për punë sociale nuk kemi kurrfarë mjete për të mbuluar këtë kategori.

Afërdita Thaqi – Sa e kuptova unë janë tre kriter që duhet të plotësohen për të përfituar një familje ndihmën sociale, kriteri i parë është që të jetë i papunë, kriteri i dytë nëse i plotëson kushtet sipas ligjit dhe kriteri i tretë është që të ketë fëmijë nën moshën 5 vjeçare. Por nëse njëri nga këto kriteret nuk përmbushet a do të përfitoj ajo familje ndihmën sociale. Po ashtu kam një kërkesë për kryesuesin, kishte me qenë mirë që ti shfletoj pak ligjet para se të bëjë pyetje.

Kryesuesi – E nderuar ju më keni keqkuptuar, nuk kam kërkuar pagesën e qeras, e di që komuna nuk ka mjete që ti ju paguaj qiranë, por kriteri nr. 1 e tha edhe drejtori se duhet të jetë nën moshën 5 vjeçare, por kërkesa ime ishte që ato mjete që ndahen të i gëzojnë familjet që me të vërtet kanë nevojë.

Ramë Berisha – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kur bëhet fjalë për ndihmë familjarëve që kanë nevojë, para disa viteve ka qenë një rast u një familje ka kërkuar ndihmë për një fëmijë, por kjo familje nuk ka gjetur mbështetje nga Qendra për Punë Sociale, prandaj mënoj se duhet të i jepet përparësi rasteve që janë pak më me urgjencë se sa rasteve që munden të presin.

Bylbyl Oruçi - Po i përgjigjem së pari znj. Afërdita Thaqi, e nderuar unë i përmenda vetëm 3 kriter që janë më kryesore sa për të ju informuar, sepse për të përfituar ndihmën sociale ka një sërë kriteresh. Por nëse njëri nga këto kriter që janë më kryesore nuk përmbushet atëherë asaj familje nuk i aprovohet kërkesa për ndihmë sociale, janë diku rreth 7 ose 8 udhëzime administrative si bazë nën ligjore të cilat përcaktojnë mënyrën e veprimit për të aprovuar një ndihmë sociale. Nëse jeni të interesuar ne mundemi që të ju bëjmë edhe një specifikim të veçantë me të dhënë rreth mënyrës së aplikimit, procedurave dhe rreth dokumentacionit. Kategoria e parë ka të bëjë me persona të rritur në familje të cilët janë të paafte për punë, në këtë rast nuk është evidente çështja e fëmijëve, ky kriter bazohet në kriterin kryesor, dhe ky kriter është komisioni mjekësor. Lënda dërgohet në komisionin mjekësor regjionalë të MPMS, ne zakonisht i dërgojmë lëndët në Prizren, dhe nëse ky komision konstaton se ky fëmijë e ka të drejtën e përfitimit të ndihmës sociale, atëherë ai përfiton ndihmë sociale me një afta prej 6-12 muaj. Ishte edhe një pyetje rreth rasteve të veçanta, komuniteti RAE qendra për punë sociale respektivisht organi kujdestarisë i qendrës për punë sociale është kompetentë për kujdesin ndaj fëmijëve ose ofrimin e shërbimeve sociale, ky shërbim e ka klasifikuar komunitetin RAE si një grup i cenueshëm në aspektin social, kushtet e jetesës, kushtet e punës dhe në përgjithësi kushtet sociale dhe

ekonomike të këtij grupi janë në nivelin e padëshiruar, edhe ne si qendër për punë sociale por edhe si komunë themi se me këtë kategori duhet shumë punë dhe shumë ma shumë investime që këtë grupe të heqim nga ky përkufizim. Rastet e veçanta janë probleme të trajtohen sepse ky rast i veçantë është në përbërje të një grupi të veçantë, prandaj është shumë vështirë të përmbushen nevojat e këtij rasti në aspektin e kriterëve të përcaktuar nga ligjet e Republikës së Kosovës.

Ali Morina – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Drejtori për punë sociale i ceku të gjitha bazat ligjore sa i përket formës së aplikimit dhe respektimit të tyre, ne e dimë se komuniteti RAE është një kategori e ndjeshme dhe kanë jashtëzakonisht probleme të mëdha, por i nderuar drejtor ka disa lëshime sepse dikush mundet të përfitojë ndihmë sociale edhe nëse nuk i plotëson kushtet. Pyetje ime për drejtorin është personat të cilat nuk e meritojnë ndihmë sociale, e i verifikoni dhe nëse po atëherë në cilën fazë jeni.

Bylbyl Oruçi – Përfitimi i ndihmës sociale ndihmë kur janë në marrëdhënie pune është i ndaluar, por në shumë aspekte situata është përmirësuar shumë sa i përket kontrollit të shfrytëzuesve të ndihmave sociale, njëra nga format e kontrollit të cilën e aplikon MPMS është data baza të regjistrimit të trustit pensional. Pra përmes numrit të letërnjoftimit personi identifikohet nëse është pjesë e familjes së shfrytëzimit social, divizioni për ndihma sociale automatikisht ja ndërprejnë ndihmën. Kjo është njëra nga mënyrat e kontrollimit të keqpërdoruesve të mundshëm, ka edhe mënyra tjera por kjo është njëra e cila më së shumti praktikohet. Ne po ashtu e kemi për obligim që çdo familje e cila merë ndihmë sociale ta bëjmë verifikimin e gjendjes së tyre, pra edhe kjo mundet të thuhet se është njëra nga kontrollet që i bëhet përfituesve të ndihmave sociale.

Kryesuesi – Falënderoj drejtorin z. Bylbyl Oruçi për prezencën e tij dhe për të gjitha informatat e dhëna rreth pikës së dytë. Kalojmë në pikën e radhës:

3. Ofrimi emergjent i ndihmës momentale familjeve në nevojë gjatë sezonit dimërorë.

Ali Morina – Padyshim që jemi pro kësaj pike të rendit të ditës, por i nderuari kryesues edhe pse ne dimë autoritetin e disa njerëzve që e kanë në komunë dhe formën se si ata e kanë shtrirjen e interesave e cila më vonë ju kontribuon atyre, prandaj kisha kërkuar që së paku ky ofrim i ndihmës të bëhet në mënyrë transparente dhe të trajtohen rastet që me të vërtet kanë nevojë.

Mirjeta Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket kësaj pike mendoj se është një pikë shumë e ndjeshme dhe shumë e rëndësishme, ne jemi për që ti ofrohet ndihma familjeve në nevojë gjatë sezonit të dimrit, por kishte me qenë më mirë nëse ne do të kemi një listë me kërkesa dhe pastaj ne si anëtar të Komitetit për Komunitete ta shqyrtojmë atë listë, pastaj të vendoset se kujt do i ndahet ndihma, gjithmonë sipas mundësive buxhetore. Por nëse nuk jemi vonë kisha propozuar që kjo pikë të shtyhet për muajin e ardhshëm në mënyrë që të kemi diçka më tepër faktike, sa kërkesa do të jenë, sa kemi mundësi buxhetore, po ashtu kishte me qenë mirë që të jetë prezent dikush nga ekzekutivi i cili do na tregoj se sa janë mundësitë buxhetore, sepse ne sot jemi duke folur në ajër nuk kemi asgjë konkrete.

Ali Zhuniqi - I nderuari kryesues desha të di se kush po ti bënë këto pika të rendit të ditës.

Kryesuesi – Pasi jam kryesues i Komitetit për Komunitete dhe bashkëpunoj me të gjitha anëtarë të komitetit për komunitete, po ashtu kam kontakte të vazhdueshme me të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën tonë, e kam parë të arsyeshme që të qes këto pika për këtë mbledhje.

Ali Zhuniqi – Mbas cilave linja buxhetore mendon që të paguhet këto ndihma për nevojat të familjeve skamnore, i nderuari kryesues unë jam pro kësaj pike gjithsesi, por nuk dua që kjo të keqpërdoret sepse ka raste që keqpërdoren mjetet që janë të destinuara për ndihmë familjeve në nevojë, ne jemi dëshmitarë të kohës sepse që nga pas lufta këto gjëra janë duke u keqpërdorur. Përndryshe unë desha të japë vetë një sugjerim, përndryshe ju jeni kryesues dhe ju e keni përgjegjësin sepse i mbron interesat e komuniteteve jo shumicë.

Mirjeta Krasniqi – I nderuari kryesues nëse keni një listë me kërkesa nga ato familje që kanë nevojë për ndihmë, kishte me qenë mirë që të na sillni neve këtu, nëse nuk e keni atëherë e shtymë për mbledhje të radhës.

Skender Hamza, Udhëheqës i Sektorit të Kuvendit - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar ju si anëtar të Komitetit për Komunitete kishte qenë më së mirë që të dilni me një rekomandim dhe të i drejtoheni me një kërkesë kryetarit të komunës për ndarjen e ndihmave familjeve në nevojë, nëse ju e keni një listë atëherë kishte me qenë besoj edhe më mirë por edhe më lehtë edhe për kryetarin. E them këtë sepse edhe nëse e shtynë për mbledhje tjetër asgjë nuk mundeni të bëni, ko ishte vetëm një sugjerim i imi.

Afërdita Thaqi – Pajtohem me mendimin e z. Skender Hamza, por i nderuari kryesues është e vërtet se ndoshta këto pika nuk vinë nga ajari por ju i formuloni, por kishte me qenë mirë që edhe kërkesat të i keni, sa persona kanë nevojë, pastaj për çka kanë nevojë, si është gjendja e tyre shëndetësore etj. e pastaj mendoj se kishte me qenë mirë të futet si pikë e rendit të ditës, e jo kështu si na ke sjellë.

Ramë Berisha – Pikat e rendit të ditës në këtë takim mendoj se janë me vend dhe duhet që të respektohen. Sa i përket pikës që jemi duke e diskutuar, ne e dimë se tani jemi duke shkuar ka stina e dimrit dhe shumë familje kanë nevojë për ndihma si për nxehje ose gjëra ushqimore. Ne si anëtar të K. Komunitete duhet të jemi sy hapur dhe të mos i jepet atyre familjeve që nuk kanë nevojë, sepse ka mjaftë familje që kanë nevojë për një ndihmë sado e vogël që të jetë.

Kryesuesi – A jeni të pajtimit që rekomandimi i komitetit për komunitete është: Ne si komitet të i drejtohem kryetarit me një kërkesë që të i ndajë disa mjete për ndihmë familjeve në nevojë gjatë sezonit dimërorë. E qes në votim Rekomandimin: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rekomandimi i lartë cekur i Komitetit për Komunitete. Kalojmë në pikën e radhës:

4. Ndarja e mjeteve buxhetore nga buxheti i ZKK-së për ndërtimin e një biblioteke të leximit në fshatin Ratkoc.

Mendoj se të gjithë e keni projektin për ndërtimin e kësaj salle para vete, diçka më shumë nuk kam çka të shtoj nëse ka dikush diçka të shtoj fjalën e ka.

Mirjeta Krasniqi – Ne e përkrahim këtë pikë sepse të forcohet një komunitet ose një popull duhet që të arsimohet, pra arsimit është arma kryesore. Kjo sallë siguron kushte më të mirë për komunitetin RAE në fshatin Ratkoc, por edhe të fshatrave në rrethin, ne këtu i kemi të dhënat se sa nxënës janë në këtë shkollë, 40 nxënës të komunitetit RAE janë nga fshati Ratkoc, por ka edhe nxënës nga fshatrat përreth që munden të vinë dhe ta shfrytëzojnë këtë sallë të leximit. Ky fonde është për komunitetin pakicë, prandaj ne jemi këtu që të i sigurojmë që të kenë të gjithë të drejtën e barabartë në qasje ndaj fondit, në mënyrë që të krijohen kushtet sa më të mirë për këtë komunitet pakicë qoftë serb apo RAE.

Ramë Berisha – Ky aksion për rregullimin e bibliotekës në shkollën fillore në Ratkoc, mendoj se është e tepërt që të përcaktohet që do shërbej vetëm për komunitetin RAE, mendoj se kjo sallë duhet që të vlejë për të gjithë pa mare parasysht se cilit komunitet i takojnë.

Kryesuesi – I nderuar në këtë shkollë mbajnë mësim edhe komuniteti shumicë, kjo shkollë i ka afër 1000 nxënës, prandaj komunikimi dhe marrëdhëniet ndërmjet komunitetit shumicë dhe pakicë janë të shkëlqyera. Prandaj këtë sallë do e shfrytëzojnë edhe nxënësit e komunitetit shumicë, po ashtu edhe nxënësit e shkollë së mesme munden të shfrytëzojnë këtë sallë për lexim.

Ali Morina – Sa i përket këtij projekti i cili kapë shumën dikur rreth 10,400.00 €, aspektin e realizimit të shpenzimeve e analizova pak dhe më duket se janë të paarsyeshme, p.sh karika hidraulike një copë 140.00 €, a nuk ka mundësi që të jetë një karikë ma e thjeshtë dhe ma e lirë dhe me ato mjete të blihen edhe 20 libra më shumë, pastaj tavolinë për kompjuter shuma 80.00 €, unë për mua e kam blerë 50.00 € dhe është jashtëzakonisht e mirë. Ju lutem që mos të më keqkuptoni nuk jam kundër që të investohet në këtë bibliotekë, por unë jam kundër mënyrës se si këta i bëjnë analizimin e shpenzimeve. Pastaj raftet për libra 50,000.00 €, titujt të ndryshëm 1,9,12, një copë 5 €, 1000 copë 5,000.00 € etj. Mua këtu më dyshimi që kryetari me autoritetin e tij e atribuon bibliotekën në fshatin e vetë Ratkoc, dhe nuk më bindë mua me këto zëra buxhetore, prandaj dyshoj se ka manipulime në kuadër të këtij projekti, sepse nëse i krahasojmë çmimet mesatare dhe çmimet që këtu janë paraqitur ka diku ngritje deri në 40% karshi çmimit mesatar.

Kryesuesi – I nderuari z. Ali Zhuniqi por të flas me sinqeritetin më të madh, unë vijë nga fshati Ratkoc, sa i përket këtij projekti i nderuar nuk është në dijeni fare kryetari i komunës, ky është një propozim i imë dhe unë vetë e kam punuar këtë projekt sepse ka nevojë për një bibliotekë. Sa i përket çmimeve që janë në këtë projekt nuk janë të sakta, janë çmimet të përafërta dhe munden të ndryshohen.

Ramë Berisha – Ne e imë që kjo bibliotekë do shërbejë për të gjithë, por duhet që të punohet me sinqeritetin më të madh pa kurrfarë dallavere, ka kohë që jam duke kërkuar që të shtrohet një rrugë me gjatësi 80m e gjatë dhe 6m e gjëra, ku kalojnë shumë familje në këtë rrugë, e cila nuk e besoj se do kushtojë më shumë se 5,000.00 €, por ende nuk ka kurrfarë rezultati. Ndërsa ju të gjithë buxhetin e pakicave doni ta orientoni në projektin e bibliotekës, prandaj mendoj se duhet të preken secili projekt nga pak e jo vetëm njëri.

Kryesuesi – Të nderuar unë dua një bashkëpunim me ju me e bë këtë e jo të bëjë në krye veti sepse kjo është në të mirën e të gjithë nxënësve.

Ali Morina – Sa i përket analizimit të shpenzimeve që i keni bërë, ku e thatë se i keni bërë paushallë, mendoj se duhet ose të punohet mirë ashtu si duhet ose fare mos të punohet, nëse nuk dini atëherë duhet të kërkoni konsultë sepse ka ekspertë të cilët do të bëjnë analizimin e buxhetit karshi investimeve. Pse nuk më keni kërkuar ndihmë nga unë, me profesion jam ekonomistë e kishim bërë të dytë plan projektin, por të them me sinqeritetin më të madhe për mua ky projekt nuk është bindës sepse unë i kam dyshimet e mija rreth këtij projekti.

Afërdita Thaqi – I kisha lutë kolegët e mijë pasi që ky projekt shkon në favor të nxënësve, për tu arsimuar dikush jam në gjendje që të japë edhe nga xhepi imë, prandaj kishte me qenë mirë që ky projekt të përkrahet nga ne, dhe nuk më duket e arsyeshme që të diskutohet më shumë rreth kësaj pike.

Kryesuesi – I nderuar z. Ali Zhuniqi e thash më parë jam pro asaj që të ulemi dhe ta studiojmë projektin, nëse duhet të ndryshohen çmimet le të ndryshohen këto nuk janë çmimet përfundimtare. Qëllimi i vetëm i imë ka qenë që këto mjete që janë të dedikuara për ZKK-në të mos shkojnë diku tjetër por të shfrytëzohen në të mirën e komunitetit si pakicë ashtu edhe shumicë.

Skender Hamza - Të nderuar do zoti që ky projekt të mirët parasysh nga ana e kryetarit të komunës, ky projekt është vetëm si formalitet, sa e di unë komuna e ka një kompani të kontraktuar e cila bënë projekte për komunën, dhe pasi që të bëhet projekti atëherë ky projekt shkon përmes zyrës së prokurimit dhe kompania e cila dele me çmimin më të ulët e fiton projektin, kështu mendoj unë se janë procedurat, nuk do të thotë që është e saktë kjo që e thash.

Kryesuesi – E qes në aprovim Propozimin për ndarje të mjeteve buxhetore nga buxheti i ZKK-së për ndërtimin e një biblioteke të leximit në fshatin Ratkoc: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e katërt (4) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e fundit:

5. Të ndryshme.

Ramë Berisha – Kërkesat që jemi duke i bërë ne që janë goxha të nevojshme, nuk e di a janë duke u marrë parasysh nga kush, e çeke më parë kërkesën për ndërtimin e një rrugë por ende asnjë përgjigje nuk kemi marr.

Kryesuesi – I nderuari z. Ramë Berisha buxheti për vitin 2019 është aprovuar nga kuvendi komunal, dhe besoj se në vitin 2019 ajo rrugë do të rregullohet, sepse sipas informatave që i morëm është në projekt edhe rregullimi i asaj rruge që ju jeni duke kërkuar. Ju faleminderit për pjesëmarrje, me kaq kjo mbledhje ka përfunduar shihemi në takimet e radhës.

Mbledhje ka përfunduar në ora 11:40

[Signature]



Prodesmbajtësi
[Signature]
Skender Hamza

